



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr.1500/3 Prot

Tiranë, më 25.10.2023

VENDIM

Nr.48, datë 25.10.2023

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, znj. _____, në cilësinë e gazetares pranë Organizatës “Albanian Center for Quality Journalism” ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1500 Prot., datë 14.09.2023, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, nëpërmjet kërkesës datë 24.08.2023, depozituar në adresën elektronike info@azhbr.gov.al, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

- Të gjitha projektet e përfituesve të shpallur fitues të fondeve të BE-së dhe Qeverisë Shqiptare për agroturizëm në kuadër të IPARD-it për të katërta thirrjet.

Autoriteti Publik, me e-mail-in datë 06.09.2023, i ka kthyer përgjigje ankueses, duke sqaruar se: “Implementimi i programit IPARD, procedurat e përzgjedhjes dhe aprovimit të projekteve, bazohen në Marrëveshjen Kuadër, ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit European për rregullat e zbatimit të asistencës financiare të BE për Shqipërinë në kuadër

të instrumentit për asistencën e para-anëtarësimit (IPA II), në Marrëveshjen Sektoriale ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian që përcakton dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të asistencës financiare të BE për Republikën e Shqipërisë në kuadër të instrumentit për asistencën e para-anëtarësimit në fushën "Bujqësia dhe Zhvillimi Rural" (IPARD), si dhe në Udhëzimin për Aplikantët e Programit IPARD II, të cilat i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të AZHBR. Referuar nenit 23 të Marrëveshjes Kuadër, ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Shqipërinë në kuadër të instrumentit për asistencën e para-anëtarësimit (IPA II). d) Strukturat operuese garantojnë informimin e marrësit të asistencës se do të figurojë në listën e publikuar për këtë qëllim. Të dhënat personale që shpallen në këtë listë trajtohen në përputhje me kërkesat e Rregullores (KE) Nr. 45/2001 dhe duke respektuar kërkesat mbi konfidencialitetin dhe sigurinë e të dhënave.

Gjithashtu, referuar Nenit 29 "Informimi, publiciteti dhe transparenca" të Marrëveshjes Sektoriale ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian që përcakton dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë në kuadër të instrumentit për asistencën e para-anëtarësimit në fushën "Bujqësia dhe Zhvillimi Rural" (IPARD):

(1) Shqipëria jep informacion dhe bën publicitet të programit IPARD II dhe të kontributit të BE-së, sipas Shtojcës 8. Grupi i synuar për t'u informuar është publiku i gjerë. Informacioni nënvizon rolin e BE-së dhe garanton transparenca të asistencës së BE-së.

(2) Me qëllim që të garantohet transparenca për mbështetjen e IPARD, Agjencia IPARD është përgjegjëse për publikimin e listës së operacioneve dhe përfituesve të asistencës IPA II, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 23, pika 2 të MK-së. Publikimi bëhet në format Excel, që mundëson ndarjen, kërkimin, nxjerrjen, krahasimin dhe publikimin e lehtë në internet të të dhënave, për shembull në format CSV apo XML. Lista e operacioneve duhet të gjendet në faqen e internetit apo në portalin e internetit. Informacioni minimal që duhet të përmbajë lista e operacioneve është përcaktuar në Shtojcën 8 të kësaj Marrëveshjeje.

Lista e operacioneve që i referohet nenit 29 (3) përmban fushat e të dhënave të mëposhtme:

- emri i përfituesit (vetëm i subjekteve juridike; jo i personave fizikë);
- emri i operacionit;
- përmbledhje e operacionit;
- data e fillimit të operacionit;
- data e përfundimit të operacionit (data e parashikuar për përfundimin fizik ose zbatimin e plotë të operacionit);
- shpenzimet totale të pranueshme që janë përcaktuar për operacionin;
- shkalla e bashkëfinancimit të Bashkimit Evropian, sipas aksit prioritar;
- kodi postar i operacionit; ose një indikator tjetër i përshtatshëm për vendndodhjen;
- vendi;

- emri i kategorisë së ndërhyrjes për operacionin;
- data e përditësimit të fundit të listës së operacioneve.

Referuar kërkesës suaj për vënien në dispozicion në dispozicion të projekteve të aplikimeve të shpallur fitues të fondeve të BE-se dhe Qeverisë Shqiptare për agroturizëm në kuadër të Programit IPARD II, për të katërta thirrjet, të, ju bëjmë me dije se kjo është një e dhënë konfidenciale ndërmjet kontraktuesit dhe përfituesit dhe nuk mund t'ju vihet në dispozicion palëve të treta, përveçse kur kërkohet nga Organet e Drejtësisë. Aplikantët, japin pëlqim në deklaratën e tyre që pranojnë që të dhënat e tyre personale, si dhe dokumentacioni do t'i vendoset në dispozicion shërbimeve të Auditit të Brendshëm, Gjykatës Evropiane të Auditorëve, Zyrës Evropiane Kundër Mashtrimit, si dhe organeve të drejtësisë, dhe jo personave të tretë.

Gjithashtu, projektet arkitekturore, trajtohen sipas ligjit nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", në nenin 2 "Subjektet dhe fusha e zbatimit" citohet se: Ky ligj zbatohet për personat fizikë, juridikë, vendas ose të huaj, që ushtrojnë veprimtari krijuese, tregtare, prodhuese ose çdo veprimtari tjetër vlerësimi, shfrytëzimi, përdorimi a tjetërsimi të veprave letrare, artistike ose shkencore në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për:

a) veprat: v) arkitekturore, të ndërtuara në territorin e Republikës së Shqipërisë; Neni 4 "Njohja, publikimi, publiku dhe përdorimi publik", 1. Një vepër e mbrojtur nga e drejta e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të do të konsiderohet se është "e njohur" nga publiku në qoftë se është vënë në dispozicion të publikut me pëlqimin e mbajtësit të së drejtës.

Sa më sipër bazuar në nenin 7, "Kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë" të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" i gjithë informacioni që mund t'iu vendosim në dispozicion, është i publikuar në faqen zyrtare të AZHBR dhe mund të aksesohet lehtësisht nga kushdo që është i interesuar."

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesja pretendon se nuk i është vënë në dispozicion informacioni i kërkuar duke cituar se: "Pavarësisht se mes autoritetit dhe përfituesit të fondeve mund të ketë një marrëveshje konfidencialiteti, investimet e kryera nga këta të fundit janë kryer me fonde publike, përtej kësaj janë investime të cilat janë fizike dhe të dukshme, dhe në këtë pikë nuk qëndron konfidencialiteti, për sa kohë ne kërkojmë të dimë vetëm projektin që është financuar me fonde publike. Praktika e institucioneve publike, përfshirë këtu dhe praktikën e vendimmarjes së Komisionerit për të Drejtën e Informimit, vazhdimisht i ka dhënë përparësi aksesit në informacion të publikut, sidomos kur investimet kryhen me fonde publike. Për më tepër, kontratat TIP të vëna në dispozicion nga AZHBR nuk përfshijnë në asnjë pikë të tyre klauzola konfidencialiteti apo të drejtat e palëve për parapëlqim për vënie në dispozicion të informacionit të kontratave apo dosjes së tyre kundrejt vënes në dispozicion palëve të treta. Nëse AZHBR pretendon se informacioni i kërkuar "është një e dhënë konfidenciale ndërmjet kontraktuesit dhe përfituesit dhe nuk mund t'ju vihet në dispozicion palëve të treta, përveçse kur kërkohet nga Organet e Drejtësisë. Aplikantët, japin pëlqim në deklaratën e tyre që pranojnë që të dhënat e tyre personale, si dhe dokumentacioni do t'i vendoset në dispozicion shërbimeve

të Auditit të Brendshëm, Gjykatës Evropiane të Auditorëve, Zyrës Evropiane Kundër Mashtrimit, si dhe organeve të drejtësisë, dhe jo personave të tretë” atëherë kjo duhet të jetë e parashikuar në kontratë, ose në një kuadër ligjor të mirëpërcaktuar, dhe jo të përdoret si pretekst për mosvënie në dispozicion të informacionit. Nëse ky kuadër ligjor ekziston, kërkojmë të na citohet specifikisht, me të gjithë klauzolat përkatëse që aplikohen për rastet në fjalë. Nëse ekziston një klauzolë kontraktuale për konfidencialitet të tilla, kërkojmë të na vihet në dispozicion një kopje, e firmosur nga palët, si dhe kuadri ligjor specifik mbi të cilin zbatohet ajo klauzolë, e cila me sa duket ka një fuqi më të lartë se sa Ligji për të Drejtën e Informimit.

Edhe për sa i përket mosdhënies së informacionit për shkak “Të të drejtave të autorit”, praktika e Komisionerit për të Drejtën e Informimit, tregon që për sa kohë një dokumentacion, i cili e përfshin këtë pikë, bëhet pjesë e dokumentave të administruara nga një institucion publik, për sa kohë ne nuk do i përdorim këto informacione dhe të drejtat e cituara për qëllime fitimprurëse por për interes publik në informim, ajo e drejtë humbet, aq më shumë duke pasur parasysh se projektet që citohet se kanë punime të mbrojtura nga e drejta e autorit financohen me fonde publike. Dëshirojmë të ripërsërisim në këtë pikë qëllimin kryesor të kërkesës, që është informimi i publikut dhe jo e karakterit ekonomik”. Ndodhur në këto kushte, ankuesja i është drejtuar Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së dokumentacionit nga Autoriteti Publik.

Ndërkohë, pranë Komisionerit është depozituar edhe ankesa nr. 1706 Prot., datë 19.10.2023 nga z. _____, në cilësinë e drejtorit ekzekutiv të Organizatës “Albanian Center for Quality Journalism”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”. Ky i fundit, nëpërmjet kërkesës datë 10.10.2023, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

- *Një kopje të plotë të projektit të depozituar (pjesa narrative dhe jo plani i biznesit financiar) dhe i miratuar nga ana e Autoritetit Publik për të katërta thirrjet.*

Me emailin e datës 18.10.2023, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje për ankuesin duke mbajtur të njëjtin qëndrim të shprehur edhe më herët në ankesën e depozituar nga znj. Xhaferri. Në vijim, z. Hoxha kërkon nga Komisioneri ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënie e informacionit/dokumentacionit të kërkuar duke cituar pretendimet e tij si më poshtë vijon: “Për sa i përket parashikimit “Referuar nenit 23 të Marrëveshjes Kuadër, ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Shqipërinë në kuadër të instrumentit për asistencën e para-anëtarësisimit (IPA II): d) Strukturat operuese garantojnë informimin e marrësit të asistencës se do të figurojë në listën e publikuar për këtë qëllim. Të dhënat personale që shpallen në këtë listë trajtohen në përputhje me kërkesat e Rregullores (KE) Nr. 45/2001 dhe duke respektuar kërkesat mbi konfidencialitetin dhe sigurinë e të dhënave.”, është një parashikim i përgjithshëm i cili garanton trajtimin e të dhënave personale specifike,

që përcaktohen nga rregullorja në fjalë si të dhëna personale. Në këtë kuadër, të dhënat personale të përfituesve të fondeve të IPARD trajtohen nga institucioni përkatës në bazë të legjislacionit lokal dhe rregullores në fjalë.

Në asnjë rast nuk janë kërkuar të dhëna personale të personave përfitues, qofshin persona fizikë apo juridikë. Vetë rregullorja përcakton si të dhëna personale “çdo informacion që lidhet me një person të identifikuar ose të identifikueshëm referuar si "subjekti i të dhënave"; një person i identifikueshëm është ai ose ajo që mund të identifikohet, drejtpërdrejtë ose në mënyrë indirekte, në veçanti përmes një numri identifikimi ose përmes një ose më shumë faktorëve specifikë të identitetit fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të tij ose të saj.” Siç mund të shihet dhe nga kërkesa e paraqitur, asnjë nga informacionet e kërkuara nuk lidhen me personin specifik, por me investimin e financuar nga AZHBR dhe buxheti i shtetit, dmth, kategori objekti/subjekti të drejtash nëse do të quhet i tillë i cili nuk mbulohet nga rregullorja në fjalë. Në këto kushte, duke qenë se të dhënat kryesore të publikuara tashmë nga AZHBR, janë të dhëna personale tashmë në domein public, nuk është e qartë se çfarë të dhënash të tjera personale mund të përfshihen në dokumentacionin e kërkuar të cilat shkojnë përtej atij tashmë të publikuar. Megjithatë, edhe në rast se një informacion i tillë ekziston, informacion i cili përfshihet në përkufizimin e të dhënave personale të individit, jemi mëse dakord që ky informacion të redaktohet, por pa limituar përmbajtjen thelbësore të informacionit të kërkuar, më konkretisht, projektet fituese. Edhe për sa i përket Nenit 29 “Informimi, publiciteti dhe transparencë” të Marrëveshjes Sektoriale ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, dhe citimit se vetëm të dhënat e listuara nga AZHBR mund të jepen si informacion nuk qendron, për sa kohë neni cituar nga kjo marrëveshje flet për një gamë detyrimesh vizibiliteti dhe transparence minimale dhe jo kufizuese. Detyrime të tilla kontraktore janë të përfshira në të gjithë marrëveshjet për grantime, subgrantime, financime apo mbështetje nga institucionet e BE-së, dhe janë të dhëna që bëhen publike nga zbatuesi i programeve si pjesë e kushteve të vizibilitetit të programeve, por në asnjë rast nuk janë penguese për përcjelljen e informacionit të mëtejshëm tek publiku. Edhe nëse shikohet me kujdes Shtojca 8 e përcaktuar në Marrëveshje, të cilës i referohet AZHBR, transparencë dhe vizibiliteti në fjalë lidhet ngushtë me detyrimet e zbatuesve të programeve për të qënë transparent me mënyrën se si përdoren fondet e BE-së dhe të përfituesve për të “reklamuar” faktin që arritjet e projekteve të tyre janë si pasojë e mbështetjes nga BE. Në asnjë rast, nuk mund të shihet një dispozitë e tillë si një kushtëzim kufizues për marrjen e informacionit në fjalë, (1) për shkak se nuk ekziston asnjë kufizim i cili në marrëveshje të përcaktohet verbatim se nuk lejohet dhënia e informacionit në fjalë; (2) në asnjë pikë të marrëveshjes nuk parashikohet që informacioni në fjalë “nuk mund t’ju vihet në dispozicion palëve të treta, përveçse kur kërkohet nga Organet e Drejtësisë”, ky është një interpretim arbitrar me qëllim të vetëm justifikimit e mosdhënies së informacionit të kërkuar; (3) në asnjë rast një marrëveshje e lidhur mes Këshillit të Ministrave dhe një organi ndërkombëtar nuk mund të ketë prioritet mbi parashikimet e Ligjit për të drejtën e informimit për shkak të vetë hierarkisë së normave në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe (4) nuk mund të pretendohet që projektet e kërkuara të kenë një trajtim preferencial arbitrar, ndryshe nga trajtimi i informacionit

për projektet e tenderave publikë, për sa kohë edhe këta financohen nga buxheti i shtetit, si dhe vetë BE ka qasje maksimale transparence për sa i përket projekteve të financuara me fonde publike (referojuni Direktivës 2014/24/EU mbi prokurimin publik).

Edhe për sa i përket kontratës së lidhur mes palëve dhe pretendimeve se informacioni nuk jepet për shkak se “Aplikantët, japin pëlqim në deklaratën e tyre që pranojnë që të dhënat e tyre personale, si dhe dokumentacioni do t’i vendoset në dispozicion shërbimeve të Auditit të Brendshëm, Gjykatës Evropiane të Auditorëve, Zyrës Evropiane Kundër Mashtrimit, si dhe organeve të drejtësisë, dhe jo personave të tretë.”, në asnjë rast kjo kontratë nuk mund të bjerë ndesh me parashikimet ligjore në fuqi për të drejtën e informimit, dhe si parim kryesor i Kodit Civil, çdo marrëveshje që bie ndesh me parashikimet e këtij kodi dhe ligje të tjera në fuqi, është absolutisht e pavlefshme.

Për më tepër, parashikimi i cituar sërish lidhet me informacione personale, informacione të një karakteri i cili identifikon personin. Rikujtoj këtu që informacioni personal në fjalë është tashmë publikuar nga AZHBR, dhe nuk është e qartë se cili informacion është ai i cili është i një karakteri personal që me të vërtetë preket nga kërkesa. Nuk po kërkoj gjendjen civile të subjekteve, të dhënat e tyre bankare apo informacion të një karakteri konfidencial. Po kërkoj planet e projekteve fituese, të vlerësuara nga AZHBR, në linjë me ligjin shqiptar në fuqi, dhe të financuara nga buxheti i shtetit. Për sa kohë një projekt është financiar nga buxheti i shtetit, ky i fundit, konform edhe rregullave për transparencë të aplikuara në të gjitha procedurat për tenderim publik (analoge) nuk mund të fshihen pas pretekstit të konfidencialitetit dhe të dhënave personale, për refuzim të dhënies së informacionit me karakter qartazi publik.

Sa i përket pretendimit se ky informacion ruhet nga detyrimet për konfidencialitet për shkak të të drejtave të autorit, është e paqartë dhe në asnjë rast nuk është sqaruar nga AZHBR se si e drejta e autorit e pretenduar limiton të drejtën e këtij insitucioni për të dhënë informacionin. Në këto kushte, ky pretendim nuk qëndron për shkak se: Nuk është sqaruar në asnjë rast se cilës të drejtë autori i referohet AZHBR në këto raste, kur projektet në fjalë janë projekte zhvillimi të cilat nuk po kërkohen që të kopjohen dhe të zbatohen në hapsira të tjera, në këto kushte duke shkelur të drejtën e autorit; Nuk mund të pretendohet limitim bazuar tek e drejta e autorit për investime të financuara nga fonde publike, pasi në këto kushte do të aplikohet e drejta e autorit në cdo punim publik, rrugë, ure, autostrade, ndërtesë, shesh, pazar etj. apo çdo strukturë tjetër e cila është financuar nga fonde publike, por është konceptuar nga dhe zbatuar nga subjekte private përfituese të këtyre fondeve. Këtu nuk jemi përpara një situate në të cilën subjekti ka vetëfinancuar veprën, e ka të fshëhur dhe pa akses të publikut. Janë përdorur fonde publike, dhe për këtë arsye parimi i transparencës publike duhet të jetë maksimal, si për sa i përket parimeve të aplikuara në rang shteti, po ashtu edhe parimet e vetë BE-së në këtë fushë. Komisioneri për të Drejtën e Informimit ka një praktikë të mirëthemëluar për sa i përket pretendimeve të ngritura nga institucionet publike në lidhje me të drejtën e autorit, e cila prashikon se në moment që një plan apo projekt administrohet nga institucionet publike, të drejtat e autorit si pretekst për limitim të transparencës bien poshtë, për sa kohë përdorimi i informacionit të mare nuk çon në shkelje të të drejtave të autorit. Sërish këtu kyç është një sqarim se si të drejtat e autorit shkelen nga vënia në dispozicion të publikut të planeve arkitektonike të disa ndërtesave që tashmë në bazë të vetë këtyre planeve janë

ndërtuar dhe janë të aksesueshme dhe të shikueshme nga publiku, duke e bërë këtë pretendim të paqëndrueshëm. Në këtë rast nuk po kërkojmë informacionin në fjalë për kopjim të veprimtarisë artistike për riprodhim, apo shitje apo përvetësim. Bëhet fjalë vetëm për transparencë publike se ku kanë shkuar fondet publike. Pretendimet e ngritura nga AZHBR janë tërësisht dhe në çdo pike absurde përtej çdo interpretimi logjik të ligjit apo dhe vetë rregulloreve evropiane të cituara.”

Nga shqyrtimi i ankesës së depozituar nga z. _____, bazuar në shkronjën ç), të nenit 65, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, konstatohet se çështja e ngritur është e njëjtë me atë të ankesës së regjistruar me nr. 1500 Prot., datë 14.09.2023 ndaj të njëjtit Autoritet Publik dhe për llogari të të njëjtit subjekt. Duke qenë se, ankesat lidhen me të njëjtin dokument dhe i drejtohen të njëjtit Autoritet Publik, Komisioneri çmon trajtimin e tyre në një vendim të vetëm.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesave, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në to, vlerësoi se ankesat përmbushin kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në të cilin parashikohet se: “...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”, bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me shkresën nr. 1500/1 Prot., datë 26.09.2023, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore. Seanca u zhvillua me prezencën e ankueses dhe përfaqësuesve të Autoritetit Publik. Gjatë seancës dëgjimore, ankuesja rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesë. Gjithashtu, përfaqësuesit e Autoritetit Publik mbajtën qëndrimin e reflektuar në përgjigjen e cituar më sipër, të cilën e depozituan edhe me shkrim gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

Pas seancës dëgjimore, me emailin e regjistruar pranë Komisionerit me nr. 1500/2 Prot., datë 19.10.2023, ankuesja ka vijuar ankimin duke kërkuar urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik për të dy ankesat e paraqitura, nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: “*Autoritet publik*” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”.

Në kuptim të këtij parashikimi, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.*

Nga shqyrtimi i çështjes, konstatohet se objekti i kërkesave për informacion lidhet me implementimin e programit IPARD, e konkretisht me rregullat e zbatimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë në kuadër të instrumentit për asistencën e para-anëtarësimit në fushën “Bujqësia dhe Zhvillimi Rural”.

Lidhur me argumentin e Autoritetit Publik se: *“Neni 29 parashikon “Informimi, publiciteti dhe transparenca” të Marrëveshjes Sektoriale ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, si dhe shtojca 8 përcakton informacionin që gjendet i publikuar në internet”,* Komisioneri vlerëson se, ky pretendim nuk qëndron, pasi kjo marrëveshje flet për një gamë detyrimesh të cilat nuk mund të jenë kufizuese. Detyrime të tilla kontraktore janë të përfshira në të gjithë marrëveshjet për grantime, subgrantime, financime apo mbështetje nga institucionet e BE-së, dhe janë të dhëna që bëhen publike nga zbatuesi i programeve si pjesë e kushteve të vizibilitetit të programeve, por në asnjë rast nuk janë penguese për përcjelljen e informacionit të mëtejshëm tek publiku. Shtojca 8 e përcaktuar në Marrëveshje lidhet ngushtë me detyrimet e zbatuesve të programeve për të qënë transparent me mënyrën se si përdoren fondet e BE-së. Për më tepër që edhe vetë BE ka qasje maksimale transparence për sa i përket projekteve të financuara me fonde publike.

Sa i përket argumentit të Autoritetit Publik se: *“...Projektet e aplikimeve të shpallur fitues janë një e dhënë konfidenciale ndërmjet kontraktuesit dhe përfituesit dhe nuk mund t’ju vihet në dispozicion palëve të treta, përveçse kur kërkohet nga gjykata. Aplikantët, japin pëlqim në deklaratën e tyre që pranojnë që të dhënat e tyre personale, si dhe dokumentacioni do t’i vendoset në dispozicion shërbimeve të Auditit të Brendshëm, Gjykatës Evropiane të Auditorëve, Zyrës Evropiane Kundër Mashtrimit, si dhe organeve të drejtësisë, dhe jo personave të tretë.”* Komisioneri vlerëson se, ky pretendim nuk qëndron. Konstatohet se, Autoriteti Publik në argumentin e parashtruar për mos dhënie të informacionit, nuk ka bërë një analizë të mirëfilltë apo të argumentojë se si kjo e drejtë kufizohet, kur është e domosdoshme, propocionale, si dhe dëmin që mund t’u shkaktojë palëve si pasojë e dhënies së informacionit të kërkuar, duke mos provuar në asnjë moment se mbi cilën dispozitë ligjore e mbështet qëndrimin e tij.

Referuar pretendimit të Autoritetit Publik se: *“Projektet arkitekurore trajtohen sipas Ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, Komisioneri vlerëson se ky i fundit nuk paraqiti asnjë provë lidhur me pretendimin e ekzistencës së të drejtave të mbrojtura të autorit në përputhje me dispozitat e ligjit të sipërcituar. Megjithatë, edhe nëse do të provohej ekzistenca e të drejtave të mbrojtura të autorit mbi informacionin/dokumentacionin e kërkuar, në bazë të nenit 78 të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, “Veprat me të drejtë autori do të lejohen të riprodhohen dhe të përcillen për publikun, për rastet konkrete, pa autorizimin e autorit ose të titullarit të së drejtës së autorit dhe pa shpërblim, për kryerjen e detyrave që lidhen me sigurinë publike, për përdorimin dhe kryerjen e procedurave gjyqësore, administrative, parlamentare dhe procedurave në arbitrazh, përveçse në rastin e përmbledhjeve”. Në këtë kuptim, veprat me të drejtë autori do të lejohen të riprodhohen dhe të përcillen për publikun, për rastet konkrete, pa autorizimin e autorit ose të titullarit të së drejtës së autorit dhe pa shpërblim, për përdorimin dhe kryerjen e procedurave administrative si në rastin konkret. Nga ana tjetër, në parim kërkesat e ankuesve për t’u informuar nuk çënojnë apo zhveshin autorin nga të drejtat e njohura me ligjin e posaçëm, si dhe mekanizmat që ky ligj i vë në dispozicion autorit dhe/ose mbajtësit të së drejtës për të mbrojtur apo gëzuar atë.*

Pavarësisht sa më sipër, në çdo rast, Autoriteti Publik duhet të kishte argumentuar moszbatimin e parashikimit në paragrafin e fundit të pikës 1 të nenit 17 të LDI, sipas të cilit informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij. Duke qenë se informacioni i kërkuar lidhet me projektet e aplikimeve të shpallura fituese të fondeve të dhëna nga Bashkimi Europian dhe Qeveria Shqiptare si një mbështetje financiare për bujqësinë dhe zhvillimin rural, interesi publik për të aksesuar informacion/dokumentacion lidhur me mënyrën e përdorimit të fondeve të dhëna në këtë rast është i drejtëpërdrejtë dhe i lartë. Rrjedhimisht, ky dokumentacion, duhet të ishte bërë publik duke garantuar kështu njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Nisur nga pretendimi i Autoritetit Publik se, *“Bazuar në nenin 7, “Kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë” të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i gjithë informacioni që mund t’iu vendosim në dispozicion, është i publikuar në faqen zyrtare të AZHBR dhe mund të aksesohet lehtësisht nga kushdo që është i interesuar”*, Komisioneri vlerëson se argumenti i dhënë nuk qëndron, pasi në kategorinë e sipërcituar bën pjesë informacioni që konsiderohet dhe bëhet publik pa kërkesë.

Sqarojmë se LDI, edhe pse jo të shprehur në mënyrë literale, bën një kategorizim të informacionit të aksesueshëm nga publiku në dy kategori kryesore: 1) *informacioni që bëhet publik pa kërkesë dhe 2) informacioni që vihet në dispozicion pas kërkesës së subjektit të interesuar*. Në kategorinë e parë, përfshihen ato kategori informacioni, të cilat publikohen dhe vihen në dispozicion nga Autoriteti Publik, pa qenë i nevojshëm angazhimi i ndonjë subjekti, ndërsa rasti konkret objekt shqyrtimi, i përket kategorisë së dytë, që përfshin ato informacione për njohjen e të cilave është e nevojshme të paraqitet

një kërkesë për informim pranë Autoritetit Publik, në përputhje me parashikimet e nenit 11 e vijues të LDI, detyrim të cilin Autoriteti Publik nuk e ka përmbushur.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, dokumentacioni i kërkuar përmbush në parim kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI sipas të cilit: *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse është prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar në formën e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të këtij ligji, sipas të cilit: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike. Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

Gjithashtu, kërkuarit/ankuesit janë gazetarë, të cilët synojnë informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik. Ky qëndrim i Komisionerit, gjen mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen *“Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë”*, vlerësoi se, pengesat e krijuara, të cilat vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të dekurajojnë punonjësit e medias ose në fusha të ndërlidhura me të, të realizojnë punën e “mbikëqyrësit shoqërorë”, duke zvogëluar mundësitë e tyre për të ofruar informata të sakta dhe të besueshme.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesave nr. 1500 Prot., datë 14.09.2023 nga znj. në cilësinë e gazetares pranë Organizatës “Albanian Center for Quality Journalism” dhe nr. 1706 Prot., datë 19.10.2023 nga z. , në cilësinë e drejtorit ekzekutiv të Organizatës “Albanian Center for Quality Journalism”, kundër Autoritetit Publik, “Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të informacionit sipas kërkesave për informacion datë 24.08.2023 dhe 10.10.2023, konkretisht: *(Të gjitha projektet e përfituesve të shpallur fitues të fondeve të BE-së dhe Qeverisë Shqiptare për agroturizëm në kuadër të IPARD-it për të katërta thirrjet, Një kopje të plotë të projektit të depozituar (pjesa narrative dhe jo plani i biznesit financiar) dhe i miratuar nga ana e Autoritetit Publik për të katërta thirrjet)*, duke respektuar kufizimet në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit, brenda datës 01.11.2023.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 25.10.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi